

William R. Hite, Jr., Ed.D.
Superintendent

8 Mars, 2022

Të nderuara Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Departamenti i Shëndetit Publik në Filadelfia (PDPH) ka konfirmuar se duke filluar nga e Mërkura, 9 Mars mbajtja e maskës do të jetë **fakultative** për të gjithë nxënësit dhe personelin e Drejtorisë Arsimore, me përjashtim të atyre në programet tona të “PreK Head Start”. Mbjtja e maskes do të kërkohet ende për të gjithë studentët dhe personelin e “PreK Head Start program”, siç kërkohet nga Departamenti i Shëndetësisë dhe Shërbimeve Njerëzore të SHBA.

Prioriteti ynë numër një mbetet mbajtja e sigurt e nxënësve tanë në shkollë, me kohë të plotë dhe në - person ku ne e dimë se ata mësojnë më mirë dhe ne e kuptojmë se kjo përfshin një përgjegjësi për ta afruar komunitetin tonë të Drejtorisë Arsimore më pranë një ndjesie normaliteti, pasi kushtet COVID-19 lejojnë . Ne e dimë se vaksinat janë mbrojtja më e mirë kundër përhapjes së koronavirusit. Aktualisht, 86% e personelit të Drejtorisë Arsimore janë plotësisht të vaksinuar dhe PDPH raporton se më shumë se 75% e popullsisë së Filadelfias mbi moshën 12 vjeç janë gjithashtu. Gjatë disa javëve të fundit, numri i rasteve të COVID-19 në Filadelfia ka mbetur vazhdimisht i ulët.

Ja çfarë duhet të dini dhe çfarë duhet të presim nga njëri-tjetri si një komunitet i kujdesshëm dhe gjithëpërfshirës:

- **Maska opsionale** - duke filluar nga data 9 Mars studentët dhe personeli mund të zgjedhin nëse duan të mbajnë apo jo një maskë në shkollat dhe zyrat tona. Disa do të vazhdojnë t'i veshin ato, ndërsa të tjerët jo. Ju lutemi, merrni parasysh me kujdes situatën tuaj personale dhe rrethanat familjare dhe bëni atë që është më e mira për ju ose fëmijën tuaj – dhe respektoni të drejtën e të gjithëve për të bërë të njëjtën gjë, edhe nëse zgjedhja e tyre ndryshon nga e juaja.
- **Mbjtja e shkollave dhe zyrave të shëndetshme** - Kjo kërkon që të gjithë ne të vazhdojmë të bëjmë pjesën tonë. Stacionet e dezinfektimit të duarve dhe higjiena


personale do të qëndrojnë në të gjitha shkollat pasi ekipi ynë i objekteve punon për të mbështetur ndërtesa të pastra dhe të shëndetshme. Dhe është e rëndësishme që familjet të vazhdojnë të ndjekin të gjitha masat e tjera të shëndetit dhe sigurisë, si p.sh.: mbajtja e fëmijës në shtëpi nëse është i sëmurë; testimi i tyre nëse shfaqin simptoma të ngjashme me COVID; karantinimi i tyre nëse kanë rezultuar pozitivë për koronavirus; dhe raportoni menjëherë rezultatet pozitive të testit për COVID-19 tek infermierja e shkollës tuaj ose dërgojini me email coronavirusreport@philasd.org. Nxënësit simptomatikë do të vazhdojnë të testohen në shkolla dhe testimi falas për nxënësit, prindërit dhe kujdestarët është i disponueshëm në cilindo nga “[mobile testing sites](#)” Drejtorise. Dhe mbani mend, tani mund të regjistroheni për të marrë katër teste të tjera falas për COVID-19 në shtëpi në [Covidtests.gov](https://www.covidtests.gov). Ju gjithashtu mund të gjeni një vend vaksinimi pranë jush [këtu](#) ose në www.vaccines.gov nëse keni vendosur kohët e fundit të vaksinoheni.

- **Një rikthim i përkohshëm i vënies së maskave në mënyrë të detyrueshme pas Pushimeve të Pranverës** – Pushimet e Pranverës fillojnë nga data 11 Prill. Si një masë paraprake shtesë për të ndihmuar në minimizimin e rrezikut të një rritjeje të COVID pas një jave mbylljeje të shkollave, të gjithë nxënësve dhe personelit do t’ju kërkohet të mbajnë një maskë gjate 18-22 Prill, javën pas kthimit nga Pushimet Pranverore.

Ne e dimë se personeli dhe familjet kanë pyetje shtesë se si ky kalim në mbajtjen e maskave opsionale do të ndikojë në protokollet e tjera të shëndetit dhe sigurisë së shkollës. PDPH ka ndarë se do të ofrojë udhëzime dhe rekomandime shtesë për Drejtorinë Arsimore më vonë këtë javë. Ndërkohë, nëse ndiheni të shqetësuar ose të pasigurt dhe keni nevojë për mbështetje shtesë, shërbimet e këshillimit falas ofrohen me telefon në 1-833-PHL-HOPE (1-833-745-4673) dhe me mesazhe në të njëjtin numër.

Faleminderit, kujdesuni dhe qëndroni të sigurt.

Me vlerësim,



William R. Hite Jr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias